**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Opština Drenas-Municipality of Drenas
**Kuvendi Komunal**
Skupština Opštine-Municipal Assembly
**Nr.02.400/01-47955 dt. 30.09.2024**

Na osnovu člana 11, 12 i 40 Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040, član 34, tačka 6 Statuta Opštine Glogovac, Uredba 12 br. 320-19332 za uslove, kriterijume i procedure za dodelu subvencija, Uredba MF-NR 04/2017 o kriterijumima, standardima i procedurama javnog finansiranja nevladinih organizacija i Uredba 02-400/01-18380 za izmenu i dopunu Uredbe za dodelu subvencija, odluka 01 br. 400/01-26131 od datuma 03.06.2024. godine, kao i budžet usvojen od strane Skupštine Opštine Glogovac za 2024. godinu, na predlog Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu. Skupština Opštine Glogovac na redovnoj sednici održanoj: 30.09.2024, usvaja ovu:

## ODLUKU
## ZA FINANSIRANJE PROJEKTA

### Član 1
Ovom odlukom traži se finansijska podrška za projekat „Napredne usluge rehabilitacije i sveobuhvatan socijalni tretman za decu i odrasle sa smetnjama u razvoju", Udruženja osoba sa invaliditetom „Handikos", u smislu pokrića troškova za razvoj aktivnosti za godine 2024.

### Član 2
Projekat Udruženja osoba sa invaliditetom „HANDIKOS" – „Pružanje usluga socijalne i rehabilitacije po standardima za decu i odrasle osobe sa invaliditetom", podržan je u iznosu od 5.000 evra (pet hiljada evra), sredstvima koja će se koristiti za pokrivanje troškova za 2024.

### Član 3
Finansiranje - Subvencionisanje projekta će se vršiti iz ekonomske kategorije subvencija i transfera/ekonomska šifra 21/611/73010/21200/0760 predviđena Budžetom za 2024. godinu Uprave za zdravstvo i socijalnu zaštitu.

### Član 4
Finansijska sredstva se prenose na račun Udruženja osoba sa invaliditetom „HANDIKOS", Uprava za zdravstvo i socijalnu zaštitu je dužna da prati realizaciju projekta za iznos sredstava za finansiranje iz člana 2. ove predložene odluke, tražeći od NVO „HANDIKOS", da preko službenika za praćenje sačini narativni i finansijski izveštaj kako bi se DSHMS obavestio o načinu trošenja sredstava.

### Član 5
O sprovođenju odluke staraće se: Predsednik Opštine, Direkcija za Budžet i Finansije i Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu.

**Član 6**

Ova odluka je stupila na snagu 15 dana od dana registracije i ocene zakonitosti od strane MALS-a, kao i 7 dana od objavljivanja na zvaničnom sajtu opštine.

Odluka se dostavlja:

- Predsedniku Opštine;
- Nadležna direkcija;
- Kancelarija Skupštine;
- Arhiv.

**Predsedavajući Sednice SO**

______________________

**Gani Krasniqi**

**Obrazloženje**

Na osnovu člana 16 stav 3 Uredbe MF-NR. 04/2017 o kriterijumima, standardima i procedurama javnog finansiranja NVO, Uredba br. 12/320-19338, dat 07.04.2017.godine za uslove, kriterijume i postupke za dodelu subvencija formirana je komisija Odlukom br. 01-400-01/12756 od 03.06.2024.godine za razmatranje i ocenu zahteva za dodelu subvencija putem javnog poziva broj 06-400/01-26133 od 03.06.2024. godine, raspisan od strane Uprave za zdravstvo i socijalnu zaštitu za 2024. godinu.

Komisija je razmatrala i ocenjivala prijave podnosilaca prijava za subvencioniranje nevladinih organizacija na osnovu navedenog javnog poziva, na koji se prijavilo ukupno šest (6) NVO:

Nakon otvaranja koverti nevladinih organizacija podnosilaca zahteva, komisija je overila dostavljenu dokumentaciju 6 organizacija podnosilaca zahteva, jer korisnik određuje Udruženje osoba sa invaliditetom „HANDIKOS" Glogovac za finansijsku podršku.

S obzirom da je vrednost finansijske podrške po osnovu javnog poziva 5,000€, ovaj iznos će biti dodeljen ovoj NVO, finansiranje-subvencioniranje projekta će se vršiti iz ekonomske kategorije subvencije i transferi/ekonomski kod 21/611/73010 /21200 /0760 predviđeno Budžetom Uprave za zdravstvo i socijalnu zaštitu za 2024. godinu.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 02/... | Nr. Prot. / Br. Prot. / Ref. No: 2558-1/2024
Nr. i fageve / Broj stranica / No. pages: 8 | Data / Datum / Date: 04, 11, 2024
Dalësa
PRISHTINË/A

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada – Government***

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Ramiz Lladrovci**, Kryetar i Komunës së Drenasit<br><br>**Gani Krasniqi**, Kryesues i Kuvendit të Komunës | |
| Kopje: | **Elbert Krasniqi,** Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal<br><br>**Jeton Qela**, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal<br><br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | |
| Përmes: | **Avni Zogiani,** Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve<br><br>**Arton Ahmeti,** Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | |
| Nga: | **Bora Duli,** U.d Drejtoresh i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Datë:<br>12.10.2024 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br><br>1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor<br><br>2.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>3. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor | **Shqiptar Ibra,** Zyrtar i Lartë Ligjor për Përafrim me Acquis, Departamenti Ligjor ,Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve<br><br>**Kimete Zekaj**, Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Referencë:<br>234/2024 |
| Lënda: | Shqyrtim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Drenasit | |
| Lloji i aktit: | **Vendim** | |

I nderuari Kryetar z. Lladrovci,
I nderuari Kryesues z. Krasniqi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

| |
|---|
| **Vendimin 02 Nr. 400/01-47955 për financimin e projektit "Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social dhe të rritur me aftësi të kufizuar"** |
| **Të miratuara më datë 30.09.2024** |
| **Të parashtruara për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.10.2024** |
| ***Të dërguara për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 04.10.2024*** |

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërme të Komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Drenasit, me anë të vendimit që është subjekt i shqyrtimit, synon financimin për projektin "Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për fëmijë dhe të rritur me aftësi" Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara "Handikos".

2. Përkundër faktit se Komunave iu jepet pavarësi financiare në menaxhimin e financave të tyre, ashtu të precizuar me nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Komunat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "**LMFPP**") dhe Ligjin Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, gjatë disponimit me të hyrat financiare komunale, e përcaktuar si në vijim:

**Neni 7**
Burimet Financiare Komunale

7.2 Komunat duhet t'i zbatojnë **dispozitat e aplikueshme** të **LMFPP** gjatë disponimit me këto burime financiare.

3. Ajo që i faktorizon edhe më shumë detyrimet e përcaktuara me dispozitat e LMFPP-së është neni 81 i LMFPP-së, në të cilin precizohet që në rastet kur ky ligj ka mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, dispozitat e LMFPP-së kanë përparësi, sikurse përshkruhet më poshtë:

**Neni 81**
Hyrja në fuqi/Shfuqizimi i legjislacionit paraprak/Zbatueshmëria

81.1. Në rast mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë të bëjnë me menaxhimin e parasë publike, **dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, do të kenë përparësi**, në pajtim edhe me nenin 36 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. **[theks i shtuar]**

4. Në rrjedhë të kësaj, LMFPP konsiderohet ligj organik që përcakton kushtet, procedurat dhe konditat ligjore për menaxhimin e mirëfilltë të financave publike në përgjithësi, dhe shpenzimin e parasë publike në veçanti.

5. Në kuptim të shpenzimit të rregullt të parasë publike, neni 17 i LMFPP-së precizon qartë se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe të shpenzohen nga **fondet e ndara dhe të alokuara** [theks i shtuar].

6. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin me Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë për buxhetin e Komunës së Drenasit, ku është evidentuar se komuna i ka të planifikuara dhe të lira ndarjet buxhetore.

7. Për më tepër, akti komunal nuk i plotëson kriteret për t'iu nënshtruar rregullave të Ndihmës Shtetërore të përcaktuara me Ligjin Nr.05 /L-100 për Ndihmën Shtetërore (LNSH), gjegjësisht nenit 7 dhe nenit 11.

8. Po ashtu gjatë shqyrtimit të aktit komunal, Ministria ka evidentuar se përfituesi i subvencionit ka statusin e Organizatës Jo-Qeveritare (OJQ) në Sistemin Elektronik të Organizatave Jo-Qeveritare (SEOJQ).

9. Për financimin publik të OJQ-ve, në gamën legjislative të Ministrisë evidentohen si relevante dispozitat ligjore të Rregullores Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve (këtej e tutje referuar si 'Rregullore për Financimin e OJQ-ve'). Rrjedhimisht, dispozitat e kësaj Rregullore janë të zbatueshme dhe relevante për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit komunal në këtë vit fiskal.

10. Në rastin konkret, Ministria nuk ka pranuar dëshmi nga Komuna e për të konstatuar nëse subvencionimi i OJQ-ve të cilat janë përfituese, është realizuar konform dispozitave të Rregullores.

11. **Mbi këto sqarime, <u>Ministria sqaron se Komuna e Drenasit ka mjete të buxhetuara dhe të lira për zbatimin e aktit komunal për këtë vit fiskal, mirëpo duke marrë parasysh se akti komunal ka të bëjë me financimin publik të OJQ-ve, aktit i konfirmohet ligjshmëria vetëm nëse janë zbatuar dispozitat e Rregullores për Financimin e OJQ-ve dhe ato të Ligjit për Ndihmë Shtetërore, ndërsa nëse këto dispozita nuk janë respektuar atëherë akti mbetet i pazbatueshëm.</u>**

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit, dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

***Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve***

VI - 020-606/5
05.10.2024

02 MAPL/110 2558 2024
97 04.10.24

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria – Vlada – Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Arton Ahmeti, U. d Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve | |
| Kopje: | Kryetar i Komunës së Gllogocit<br>Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gllogocit<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | Erblin Hetemi, U. d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Date:<br>03.10.2024<br>VI-020-606 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave | |
| 2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse | Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Shkresë përcjellëse për në MFPT | |
| Lloji i aktit: | Vendim | |

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin 02 Nr. 400/01-47955 për financimin e projektit "Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social dhe të rritur me aftësi të kufizuar", me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Duke u bazuar në nenin 3 të Rregullore (QRK) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

**Vendim 02 Nr. 400/01-47955 për financimin e projektit "Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social dhe të rritur me aftësi të kufizuar"**

I miratuar më datë: 30.09.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL, më datë: 01.10.2024

Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës
01 Nr. 400/01-47955 dt. 30/09/ 2024

01/10/2024
01 - 020-602

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34 pika 6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 Nr. 320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregullores MF-NR 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshimin dhe Plotësimin të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve, vendimit 01 Nr.400/01-26131, të dt. 03.06.2024, si dhe buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2024, me propozim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.09.2024, miratoi këtë:

## V E N D I M
## PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

### Neni 1

Me këtë vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin "Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për femijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar", të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara "Handikos", lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2024.

### Neni 2

Projekti i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara "HANDIKOS" - "Ofrimi i Shërbimeve Sociale dhe rehabilituese sipas standardeve për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara", përkrahet në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro), mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2024.

### Neni 3

Financimi- Subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike e shpenzimeve subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të parapara me Buxhetin për vitin 2024 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

### Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara "HANDIKOS", Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozimvendimi, të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ "HANDIKOS", që të bëjë raport narrativ me shkrim dhe financiar përmes zyrtarit monitorues në mënyrë që të njoftojë DSHMS-në për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.

### Neni 5

Për zbatimin e vendimit do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

## Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i mbledhjes së KK

[illegible] Krasniqi

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit.